



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 559, datë 12.11.2020

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË GJYQTARËVE KANDIDAT PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI PËR VITIN 2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 221 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative si dhe dokumentacionin e ardhur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve të cilët mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2021, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Lista me gjyqtarët kandidatë të miratuar në pikën 1 të këtij vendimi si dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet në faqen zyrtare të institucionit.
3. Kandidatët të cilët nuk janë përfshirë në listën e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar lidhur me shkaqet e përjashtimit. Në aktin e njoftimit secilit prej tyre t’i bëhet me dije e drejta për ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Ngarkohet Kryetarja e Këshillit për të përcjellë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

K R Y E T A R E